

GUIDA E BIZNESIT

KËRKESAT DHE PROCEDURAT

REGJISTRIMI
DHE LICENCIMI



Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të klimës së biznesit në Republikën e Shqipërisë, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” në muajin Dhjetor 2015, u krijua Qendra Kombëtare e Biznesit, si rezultat i bashkimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dhe Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL).

Me krijimin e QKB, regjistrimi i biznesit nga një proces gjyqësor u transformua në një proces administrativ me vetëdeklarim, në një qendër me një ndalesë. Falë kësaj, u mundësua që me regjistrimin e subjekteve në regjistrin tregtar të realizohej edhe regjistrimi i njëkohshëm i tyre pranë administratës tatimore qendrore dhe vendore, skemës së sigurimeve shoqërore e shëndetësore, inspektoratit të punës dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.

Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Veprimtaria ekonomike nxitet dhe gëzon mbrojtje nga legjislacioni shqiptar.



Skema 2: Subjektet që kanë detyrimin e regjistrimit në regjistrin tregtar të QKB

9 HAPAT QË DUHET TË NDJEKIN BIZNESET;

- 1.Regjistrimi në QKB.**
- 2.Hapja e llogarisë së tatimeve**
- 3.Nënshkrimi kontratës së qirasë apo dokumenti që tregon përdorimin e ambientit,**
- 4.Hapja e llogarisë bankare**
- 5.Fiskalizimi**
- 6.Interesimi dhe ndjekja e procedurave për tu pajisur me leje/licensë, në varësi të aktivitetit tuaj.**
- 7.Interesimi për pagesën e taksave vendore.**
- 8.Përgatitja e një vule në emër të biznesit.**
- 9.Regjistrimi për lejen e punës dhe më pas të qëndrimit për shtetasit e huaj.**

Hapja e llogarisë së biznesit në portalin qeveritar [e-Albania](#).


Ky është edhe hapi i parë i nevojshëm, për të pasur mundësi aksesi në shërbimet e tjera online. Meqenëse pjesa më e madhe e shërbimeve të tjera, merren tashmë jo nëpërmjet aplikimeve apo vizitave në institucionet e ndryshme, është e nevojshme hapja dhe aktivizimi i llogarisë së biznesit në këtë portal. Kjo nuk duhet të ngatërrohet me llogarinë tuaj personale në e-Albania, por llogaria e biznesit aty. Nëse ju jeni person juridik, regjistrimi i llogarisë së biznesit kryhet nga llogaria juaj personale; ndërsa, nëse ju jeni person fizik, aplikimi kryhet nga llogaria personale e individit.

Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania; - Zgjidhni shërbimin "**Aplikim për regjistrimin fillestar të personit fizik**" - Klikoni butonin "**Përdor**" - Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme mbi formën e shoqërisë të cilën do të regjistroni - Klikoni butonin "**Dërgo**" në faqen e fundit të formularit - Punonjësi i QKB-së proceson kërkesën e ardhur dhe në varësi të vendimit që merret i kthen përgjigje me e-mail aplikuesit


Dokumentacion :

- Kartë identiteti / pashaportë biometrike
- Adresa e saktë e vendodhjes së biznesit (prsh: Qyteti /Njësia Administrative/ Lagjja / Fshati emri i rrugës,nr. ndertesës/, Zona Kadastrale
- Parashikimi I xhiros që do të realizohet

Dokumentacion shoqërues



Dokumentacion shoqërues



FORMA APLIKIMIT NË QKB



REGJISTRIMI I BIZNESIT

Në përfundim të procesit të vlerësimit, jo më vonë se 1 ditë nga data e paraqitjes së aplikimit, nëpunësi i autorizuar mund të marrë vendimet e mëposhtme:



MIRATIM

- vërteton kryerjen e regjistrimit;
- regjistron të dhënat në regjistrin tregtar;
- lëshon certifikatat e regjistrimit të biznesit;
- gjeneron NUIS;
- publikon të dhënat.



PEZULLIM

- pezullon regjistrimin;
- njofton shkaqet e pezullimit, duke i garantuar një afat prej 21 ditësh për plotësimin ose ndreqjen e mangësive;
- Nëse plotësohen mangësitë brenda afatit, QKB kryen regjistrimin e biznesit.



REFUZIM

- aplikimi nuk është në përputhje me kushtet ligjore;
- aplikanti nuk ka plotësuar mangësitë, brenda afatit 21 ditor;
- të dhënat që kërkohen të regjistrohen janë të ndryshme nga të dhënat e regjistrueshme.

2.Hapja e llogarisë së tatimeve. (sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve)

Edhe ky proces është i nevojshëm, në pjesën e procedurave tatimore. Nga aty do të administrohen në vazhdim, deklarimet tatimore periodike, shtimi dhe largimi i punonjësve dhe administrimi në përgjithësi i përgjegjësive tuaja si tatim pagues.

Ky regjistrim është gjithashtu mjaft i thjeshtë. Aktivizimi i llogarisë tatimore, nevojitet të kryhet ditën tjetër, pas regjistrimit të biznesit (data e regjistrimit fillestar).

Regjistrimi i llogarisë së tatimeve kryhet https://efiling.tatime.gov.al/cats_public/Account/LogOn. Për të krijuar llogarinë tuaj të tatimeve, keni nevojë vetëm për numrin tuaj unik të identifikimit (NUIS ose ndryshe i quajtur NIPT).

Fjalëkalimi fillestar që përdoret për të aksesuar llogarinë tuaj është *Tatimetemia12*. Më pas do ju kërkohet vendosja e një fjalëkalimi të ri.

Bëni kujdes që të ruani fjalëkalimin e vendosur, por, edhe nëse ndodh, ju do të keni mundësi të gjeneroni një fjalëkalim të ri, nëpërmjet llogarisë tuaj të biznesit në e-Albania .

3.Nënshkrimi kontratës së qirasë apo dokumenti që tregon përdorimin e ambientit,

Kontrata e qirasë apo dokumenti që tregon përdorimin e ambientit duhet depozituar në formë elektronike, nëpërmjet llogarisë tuaj në Tatime.

Veç përdorimit nëpërmjet një marrëveshje qiraje, biznesi mund të përdorë ambientin/et, edhe nëse ato janë në pronësi të tij (biznesit dhe jo individit), apo edhe një marrëveshje hua-përdorimi.

Kuadri ligjor parashikon detyrimin e përdoruesit të pronës, për të mbajtur tatimin në burim në masën 15%, nëse Qiradhënësi nuk është i regjistruar në organet tatimore, dhe arkëton qiranë si një individ i thjeshtë. Gjithashtu ligji ka parashikuar edhe minimumin e tatimit të pagueshëm.

Qiraja minimale mujore; vetëm për qëllime tatimore, nuk mund të jetë më e ulët se sa 0.3% e vlerës referencë të pronës.

Nëse ju jeni person fizik, dhe përdorni ambientin në pronësi tuaj apo të familjarëve tuaj, ju nuk keni detyrimin për të llogaritur, mbajtur dhe paguar tatimin në burim.

Nëse ju do të paguani në të ardhmen tatimin në burim, duhet të shtoni përgjegjësinë tatimore të tatimit në burim.

Hapja e llogarisë bankare.

Për të pasur mundësinë e kryerjes së pagesave në emër të biznesit dhe arkëtimeve të pritshme ndaj biznesit, duhet patjetër të hapet edhe llogaria/të bankare rrjedhëse në emër të biznesit. Ky proces është gjithashtu detyrim ligjor i biznesit/tatimpaguesit, që nevojitet të hapë dhe depozitojë në formë elektronike informacionin e llogarive bankare, brenda jo më shumë se 20 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit fillestar.

Dokumentacioni i nevojshëm që kërkojnë bankat në këtë rast është;

- (a) Ekstrakti Historik i gjeneruar nga e-Albania,
- (b) Çertifikatë Regjistrimi (ose NIPT) e gjeneruar po nga e-Albania,
- (c) Në rastet e personave juridike Statuti dhe Akti i Themelimit,
- (d) Dokumenti i identifikimit të përfaqësuesit ligjor.

Ne këshillojmë, edhe përdorimin e shërbimit e-banking, si një mundësi mjaft e mirë dhe praktike për të kryer pagesat në të ardhmen. Ju mund të zgjidhni hapjen e llogarive bankare, në një nga bankat e licensuara të nivelit të dytë në Shqipëri

Procesi i fiskalizimit është një nga hapat më pozitive dhe vendimet më të rëndësishme, të vitit 2021. Tashmë çdo subjekt në Shqipëri, që pranon dhe lëshon fatura, është i detyruar që të përshtasë sistemin e faturimit të tij. Ky proces është shoqëruar me të panjohura dhe trajtuar shpesh si një pengesë për bizneset, për arsye të mos-kuptimit apo shtimit të kostos. Në të vërtetë, ky është një proces krejt normal, mjaft pozitiv dhe që do të ndodhte patjetër, si pjesë e zhvillimeve teknologjike në këtë fushë. Kjo është një mundësi mjaft e mirë për bizneset, për të pasur informacion në kohë reale dhe lehtësur procesin e lëshimit dhe pranimin të faturave. Ajo që ka ndryshuar në thelb, është vetëm, zëvendësimi i metodës së lëshimit/pranimin të faturave, tashmë jo nëpërmjet faturave fizike në letër, por në formë elektronike. Si çdo proces i ri ai shoqërohet me të panjohura dhe rezistencë normale nga ndryshimi, por, të paktën deri tani, dhe priten ende efekte pozitive në të ardhmen, ky proces ka lehtësuar ndjeshëm punën e përditshme të bizneseve.

Për të pasur mundësinë e pranimin dhe lëshimit të faturave një biznes duhet të ndjekë këto dy hapa:

- (a) Pajiset me Certifikatën e Fiskalizimit, e cila jepet nga ky aplikacion https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13691. Kostoja e këtij shërbimi; e pagueshme si tarifë vjetore për institucionin publik të AKSHI (Agjencia Kombëtare e Teknologjisë së Informacionit) publik është 4 000 lekë/vit, dhe
- (b) Zgjedhë për të përdorur, nga lista e kompanive të certifikuara <https://www.tatime.gov.al/c/424/494/lista-e-subjekteve-te-certifikuara> një nga zgjidhjet e njohura softuerike, për lëshimin/marrjen e faturave elektronike.

Interesimi dhe ndjekja e procedurave për tu pajisur me leje/licensë, në varësi të aktivitetit tuaj.

Gjithashtu një nga pikat më të rëndësishme që duhet të ndiqet në këtë fazë. Disa nga llojet e aktiviteteve, që ju mund të zgjidhni të kryeni, shoqërohen edhe me marrjen paraprake të një licensë apo leje nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Nëse ju nuk jeni pajisur paraprakisht me një dokument të tillë, mund të ndodhë që të mos keni të drejtë të kryeni aktivitetin tuaj.

Shëmbull: Nëse ju jeni një klinikë dentare, duhet që subjekti juaj paraprakisht të licensohet për të funksionuar si një klinikë dentare.

Llojet e liçensave dhe informacion për marrjen e tyre e gjeni në këtë link <https://qkb.gov.al/informacion-mbi-proceduren/regjistri-i-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/informacion-mbi-licensat-autorizimet-dhe-lejet/>.



7. Interesimi për pagesën e taksave vendore.

Pagesa e taksave vendore në Shqipëri; në pjesën kryesore të tyre, paguhen një herë në vit. Taksat dhe tarifat vendore miratohen me ligj dhe me vendim të Këshillit Bashkiak, Afati i pagesës së taksave është data 30 Qershor e vitit për të cilin paguhen taksat. Në rastin e regjistrimit rishtazi, afati i pagesës është një muaj pas regjistrimit fillestar.

Llojet e taskave dhe tarifave vendore:

- Taksë ndërtese
- Taksë mbi truallin
- Taksa e tokës Bujqësore
- Taksë Tabele
- Tarifa e Hapësirës Publike
- Tarifë Parkimi
- Tarifë Pastrimi
- Tarifë Ndriçimi
- Tarifë Gjelbërimi

8.Përgatitja e një vule në emër të biznesit.

Një ide e mirë për të pasur mundësinë e formalit të procedurave tuaja të brendshme. Gjithashtu, vula nevojitet në raste të aplikimeve apo korrespondencave në institucionet publike.

9.Interesimi për lejen e punës dhe më pas të qëndrimit për shtetasit e huaj.

Në rastin e punësimit të shtetasve të huaj në Shqipëri, nevojitet fillimisht aplikim për marrjen e lejes së punës. Në rastin e shtetasve banues në Bashkimin Europian dhe Kosovë, ligji parashikon ndjekjen e një procedurë të thjeshtuar të marrje së Leje së Punës. Në vazhdim, në punonjësi do të vijoj të qëndrojë në Shqipëri, nevojitet të pajisjet me Leje Qëndrimi.



Faleminderit!